

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

viti 2021

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	29.06.2021	<p>1.Sa eshte numri aktual(viti 2021) i gjyqtareve ne Gjykatën e Apelit Tirane?</p> <p>2. Sa eshte raporti aktual mes numrit te gjyqtareve dhe numrit te ceshtjeve per gjykim (ngarkesa e punes per secilin gjyqtar)?</p> <p>3. Sa ka qene numri i gjyqtareve ne vitet 2016,2017,2018,2019 dhe 2020 dhe sa ka qene nder vite raporti i numrit te gjyqtareve dhe numrit te ceshtjeve per gjykim (ngarkesa e punes per secilin gjyqtar)?</p> <p>4. Sa eshte aktualisht (viti 2021) dhe sa ka qene ne vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 kohezgjatja mesatare e nje gjykimi per te gjitha gjykimet e parashikuara nga Kodi i Procedures</p>	15.07.2021	<p>1. Në përgjigje të pyetjes tuaj, deri në muajin Mars 2021 numri i gjyqtarëve ka qenë 12 (dymbëdhjetë). Nga muaji Mars deri më tani numri i gjyqtarëve është 8 (tetë).</p> <p>2. Aktualisht ngarkesa është rreth 2000 çështje gjyqësore për gjyqtar.</p> <p>3. Numri i gjyqtarëve në vitin 2016 ka qenë 25 gjyqtar dhe ngarkesa e punës për gjyqtar ka qenë 200 çështje</p> <p>-Numri i gjyqtarëve në vitin 2017 ka qenë 31 dhe ngarkesa e punës për gjyqtar ka qenë 201 çështje gjyqësore.</p>	E plote	Nuk ka

¹Numri i rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

²Data e regjistrimit të kërkesës

³Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve të ligjore në fuqi

⁴Data e kthimit të përgjigjes

⁵Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve të ligjore në fuqi

⁶Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/ E deleguar

⁷Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

		<p>Civile (ceshtje familjare, marrëdhëniet e punës, pronësi, tregtare, vertetim fakti juridik, vertetesi/pavertetesi dokumenti vjetërsie në punë, sigurim padie, leshim urdhri ekzekutimi, urdher mbrojtje, pavlefshmeri titulli-ekzekutiv, kundërshtim veprimesh përmbartimore, padia për kërkimin e sendit (nga personi i tretë) dhe gjykimet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale (ceshtje penale themeli, kërkesa sekuestrore, masa sigurimi, ceshtje në seance paraprake, ekstradime, njohje vendimi penal i huaj, lirim para kohe me kusht, konstatim parashkrimi i ekzekutimit të denimit)?</p> <p>5. Sa gjyqtar janë shkarkuar si pasojë e procesit kalimtar të rivlerësimit (Vetting-tit)?</p> <p>6. Sa ceshtje gjyqësore i janë kaluar një gjyqtari tjetër, kur gjyqtari i ngarkuar i ceshtjes nuk ka mundur të kalojë procesin kalimtar të rivlerësimit (Vetting-uri)?</p> <p>7. Sa është nevojë për shtesë burimesh njerezore (gjyqtare) në Gjykatën e Apelit Tiranë?</p> <p>8. Sa është numri i ceshtjeve që janë gjykuar nga gjyqtare të deleguar në Gjykatën e Apelit Tiranë gjatë viteve 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021?</p> <p>9. Sa është vlera e përlogaritur (vlera financiare) për rekrutimin e burimeve</p>		<p>-Numri i gjyqtarëve në vitin 2018 ka qenë 28 dhe ngarkesa e punës për gjyqtar ka qenë 244 ceshtje gjyqësore.</p> <p>-Numri i gjyqtarëve në vitin 2019 ka qenë 21 dhe ngarkesa e punës për gjyqtar ka qenë 518 ceshtje gjyqësore.</p> <p>-Numri i gjyqtarëve në vitin 2020 ka qenë 18 në fillim të vitit dhe në muajin Dhjetor kanë mbetur 12 gjyqtarë dhe ngarkesa e punës për gjyqtar ka qenë 1156 ceshtje gjyqësore.</p> <p>4. Sistemi elektronik i menaxhimit të ceshtjeve (ICMIS) nuk e ofron mundësinë e përlogaritjes së kohëzgjatjes mesatare të një ceshtje dhe rrjedhimisht nuk mund të përlogaritet dhe mesatarja e ceshtjeve në tërësi.</p> <p>Nga statistikën manuale të nxjerra nga Gjykata e Apelit Tiranë rezultoi se kohëzgjatja mesatare e ceshtjeve të shqyrtuara është si më poshtë:</p> <p>Për vitin 2016 janë shqyrtuar ceshtje gjyqësore në kohëzgjatjen e mëposhtme:</p>		
--	--	--	--	---	--	--

		te nevojshme njerezore (gjyqtare) ne Gjykatën e Apelit Tirane?		<p>Çështje civile : -22 çështje deri në 2 muaj; 280 çështje për periudhën 2-6 muaj; 2307 çështje për periudhën mbi 6 muaj</p> <p>Çështje penale : - 209 çështje deri në 2 muaj; 637 çështje për periudhën 2-6 muaj; 1387 çështje për periudhën mbi 6 muaj</p> <p>Për vitin 2017 janë shqyrtuar çështje gjyqësore në kohëzgjatjen e mëposhtme:</p> <p>- Çështje civile 12 çështje deri në 2 muaj; 395 çështje për periudhën 2-6 muaj; 2327 çështje për periudhën mbi 6 muaj</p> <p>- Çështje penale 43 çështje deri në 2 muaj; 243 çështje për periudhën 2-6 muaj; 1605 çështje për periudhën mbi 6 muaj</p> <p>Për vitin 2018 janë shqyrtuar çështje gjyqësore në kohëzgjatjen e mëposhtme:</p> <p>- Çështje civile 24 çështje deri në 2 muaj; 218 çështje për periudhën 2-6 muaj; 1505 çështje për periudhën mbi 6 muaj</p> <p>- Çështje penale 500 çështje deri në 2 muaj; 411 çështje</p>	
--	--	--	--	--	--

			<p>për periudhën 2-6 muaj; 1712 çështje për periudhën mbi 6 muaj</p> <p>Për vitin 2019 dhe për vitin 2020 janë shqyrtuar çështje gjyqësore në kohëzgjatjen mbi 2 vjet mesatarisht.</p> <p>5. Në Gjykatën e Apelit Tiranë për periudhën e zbatimit të ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve</p> <p>-janë shkarkuar nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit 13 gjyqtarë dhe për tri prej tyre, vendimi ka marrë formë të prerë, kurse pjesa tjetër janë ende në proces, në pritje të shqyrtimit të ankimeve në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, duke qenë për rrjedhojë të pezulluar nga detyra;</p> <p>-6 gjyqtarë kanë dhënë dorëheqjen;</p> <p>-2 gjyqtarë kanë dalë në pension;</p> <p>-9 gjyqtarë janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe për 5 prej tyre vendimi ka marrë formë të prerë (një prej gjyqtarëve</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>aktualisht ushtron detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor). Për katër gjyqtarë të konfirmuar në detyrë, vendimi nuk ka marrë formë të prerë dhe procesi ndodhet në fazën e pritjes së shqyrtimit të ankimeve në KPA.</p> <p>6. Në vartësi të ngarkesës së gjyqtarit që nuk ka kaluar procesin e vetingut (përfshirë edhe ata të pezulluar), të gjitha çështjet e tij janë rishortuar mes gjyqtarëve në detyrë të Gjykatës së Apelit Tiranë.</p> <p>7. Gjykata e Apelit Tiranë duhet të ketë në organikën e saj 31 gjyqtarë.</p> <p>8. Për vitin 2016 numri i çështjeve që janë gjykuar nga gjyqtarë të deleguar është 1.</p> <p>-Për vitin 2017 numri i çështjeve që janë gjykuar nga gjyqtarë të deleguar është 1</p> <p>-Për vitin 2018 numri i çështjeve që janë gjykuar nga gjyqtarë të deleguar është 2.</p> <p>-Për vitin 2019 numri i çështjeve që janë gjykuar nga gjyqtarë të deleguar është 2.</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>-Për vitin 2020 numri i çështjeve që janë gjykuar nga gjyqtarë të deleguar është 2.</p> <p>-Për vitin 2021 numri i çështjeve që janë gjykuar nga gjyqtarë të deleguar është 1.</p> <p>9. Për vitin 2021 vlera e përlllogaritur (fondi i pagave) për gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Tiranë janë: 31 gjyqtar duke (përshire Kryetarin dhe Zv.Kryetarin), fondi i pages bruto vjetore është llogaritur 107.232 mijë lekë.</p> <p>Ndërkohe për 6-mujorin e parë të vitit 2021, janë 8 gjyqtar, nga të cilët 9 gjyqtar që kanë ushtruar funksionin (gjyqtari i fundit deri ne datën 8 Korrik), ndërsa 9 gjyqtar janë të pezulluar nga KPK. Fondi i pagave bruto i realizuar deri në këtë periudhë është 29.103 mijë lekë.</p>		
2	30.08.2021	Vënien në disozicion të vendimit, dhene nga Gjykata Zviceriane e	08.09.2021	Në përgjigje të kërimit tuaj, bashkëlidhur do të gjeni	E plote	Nuk ka

		Arbitrazhit, me pale shoqerine E..... dhe C.....		<p>vendimin e anonimizuar dhene nga Gjykata Zviceriane e Arbitrazhit.</p> <p>Sjellim në vëmendjen tuaj se qasja në këtë informacion duhet të trajtohet për qëllime studimore ose statistikore në respektim të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” por edhe të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar si dhe Udhëzimit Nr. 15 datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemim gjyqësor”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Udhëzimit Nr. 31 datë 27.12.2012 “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare dhe artistike”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Udhëzimit Nr. 9 datë 15.09.2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, të ndryshuar, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.		
3	01.11.2021	<p>Sa është numri i çështjeve Civile në pritje për t'u shqyrtuar nga ana e Gjykates se Apelit Tirane ?</p> <p>- Sa eshte Numri efektiv i Gjyqtareve qe Gjykojne ne Gjykatën e Apelit Tirane ?</p> <p>- Sa eshte ngarkesa e secilit prej tyre ?</p> <p>-Ne cilat vite po gjykohen aktualisht ceshtjet civile ?</p>	03.11.2021	<p>1.Numëri i çështjeve civile deri në datën 01.11.2021, të regjistruara por të pashqyrtuara është gjithësej 11714 çështje gjyqësore.</p> <p>2. Numëri i gjyqtareve që po ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Apelit Tiranë është 6 (gjashtë), ndërkohë që organika e Gjykatës së Apelit Tiranë është me 31 gjyqtar.</p> <p>3. Gjyqtarët pranë Gjykatës së Apelit Tiranë kanë në shqyrtim në total 18814 çështje gjyqësore civile dhe penale, dhe ngarkesa e tyre vijon si më poshtë:</p> <p>-Gjyqtare Edlira Petri ka në gjykim 3040</p> <p>-Gjyqtare Valdete Hoxha ka në gjykim 3484</p> <p>-Gjyqtar Ridvan Hado ka në gjykim 2080</p> <p>-Gjyqtar Genti Shala ka në gjykim 3465</p> <p>-Gjyqtare Elona Toro ka në gjykim 3260</p>	E plote	Nuk ka

				-Gjyqtare Elbana Lluri ka në gjykim 3485 4.Cështjet civile që po gjykohen në Gjykatën e Apelit Tiranë, sipas radhës së regjistrimit janë të vitit 2017.		
4	01.11.2021	<p>1- Lista emerore e avokateve, eksperteve dhe ndermjetesve të Gjykates;</p> <p>2- Cv/biografite e funksionareve të lartë (kryetarit, gjyqtareve, kancelarit, kryesekretarit, sekretareve gjyqesore);</p> <p>3- Formularet e vetdeklarimit për integritetin e gjyqtareve;</p> <p>4- Programin e transparencës dhe datën e miratimit’;</p> <p>5- Te dhënat e gjyqtarit të medias që mbulon gjykatën tuaj;</p> <p>6- Raportin vjetor të Gjykates për vitin me të fundit të analizuar;</p> <p>7- Listen e tarifave të shërbimeve që ofron gjykata dhe datën e perditesimit të fundit të saj;</p> <p>8- Buxhetin e vitit 2021;</p> <p>9- Raportin e monitorimit të shpenzimeve për vitin me të fundit financiar të analizuar;</p> <p>10- Raporti i fundit i auditimit të</p>	11.11.2021	<p>1. Regjistri elektronik i eksperteve, në bazë të nenit 224/d të K.Pr.Civile, ngarkon Ministrinë e Drejtësisë për të krijuar, administruar dhe për të vendosur në dispozicion për publikun një regjister elektronik për ekspertet. Ky regjister ndahet në seksione të ndryshme, duke grupuar ekspertet, sipas fushave të tyre të ekspertizës dhe vendit ku ata punojnë. Gjykata e Apelit Tiranë, në faqen zyrtare të webit ka të afishuar linkun e Ministrisë së Drejtësisë për regjistrin elektronik të eksperteve, (Bashkelidhur regjistri)</p> <p>-Lista emerore e avokateve kryesisht, është e afishuar në faqen zyrtare të webit të</p>	E plote	Nuk ka

		<p>brendshem ose auditimi nga Kontrolli i Larte i Shtetit ose organeve te tjera mbikqyrese (nese ka);</p> <p>11-Lista e kontratave te lidhura momentalisht me pale te treta (sherbime te kontraktuara ose tenderuara), si dhe informacion mbi Shumen e kontraktuar, palet kontraktuese, pershkrimi i mallrave ose sherbimeve te kontraktuara, plan zbatimi (afate kohore) dhe monitorimi i tyre.</p>		<p>Gjykates se Apelit Tirane, sipas shkreses nr. 2 prot, date 15.02.2021 te Dhomes Kombetare te Avokateve te Shqiperise.(Bashkelidhur lista)</p> <p>-Lista e ndermejetesve eshte e afishuar ne faqen zyrtare te webit te Gjykates se Apelit Tirane, me linkun e Ministrise se Drejtesise, (Bashkelidhur regjistri)</p> <p>2- Bashkelidhur: CV e zv.Kryetarit, Gjyqtareve, Kancelarit, Ndhimesave Ligjore, Sekretareve Gjyqesore, Arkiviste, Specialist IT, Punonjese e Burimeve Njerezore, Kryetare e Deges se Buxhetit, Ekonomiste, Specialiste e M.P.M.</p> <p>3-Forrnularet e vetdeklarimit per integritetin e gjyqtareve jane te depozituar ne KLGJ, ne baze te vendimit nr.17/2016,"Per percaktimin e rregullave te detajuara mbi zbatimin e ndalimeve te parashikuara ne Ligjin nr.138/20 15,"Per garantimin</p>		
--	--	---	--	--	--	--

			<p>e integritetit te personave qe zgjidhen, emerohen ose ushtrojne funksione publike".</p> <p>4- Programi i transparences i rishikuar se Gjykates se Apelit Tirane eshte derguar me shkresen nr.131/17 prot, date 18.01.2021 te Komisionerit per te drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dhenave Personale. Ky program eshte implementuar nga Gjykata e Apelit Tirane, ne forme dhe permbajtje si dhe informacioni perpunohet ne menyre te vazhdueshme, ne faqen zyrtare te gjykates (bashkelidhur shkresa).</p> <p>Me shkresen e KLGj-se nr.2211 prot, date 06.01.2021 eshte mbyllur faqja e web-it:www.gjykataeapelitirane.al.</p> <p>5- Gjyqtare e medias ne jurisiksionin e Apelit Tirane eshte znj. Edlira Petri, me kontakt -</p>	
--	--	--	--	--

			<p>edlira.petri@gjykata.gov.al</p> <p>6-Bashkelidhur; Pasqyrat financiare vjetore te vitit ushtrimor 2020 (gjithesej 11 faqe)</p> <p>7- Lista e tarifave te sherbimeve gjyqesore jane te afishuara tek faqja zyrtare e Gjykates se Apelit Tirane, sipas udhezimit nr.33, date 29.12.2014 te Ministrise se Financave dhe Ministrise se Drejtësisë, dhe e gjeni bashkelidhur.</p> <p>8-Bashkelidhur detajimi i fondit buxhetor korrente per vitin 2021 (gjithesej 1 faqe)</p> <p>9-Bashkelidhur “Raporti I shpenzimeve sipas Programeve” te 8 mujorit te 2020 (gjithesej 5 faqe)</p> <p>10- Ne Gjykatën e Apelit Tirane është kryer auditimi nga ZABGJ, e cila përfshin auditimin per periudhen nga 01/11/2014- 31/12/2017. Bashkelidhur: Raporti final i auditimit gjithesej 52 faqe.</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>11- Bashkelidhur "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve" te 8 mujorit te 2021 (gjithesej 5 faqe) si dhe kontratat e lidhura per blerje mallra dhe sherbimi per vitin 2021.</p>		
5	28.10.2021	<p>1.A është krijuar njësi e shërbimit ligjor? Nëse po, kur është krijuar kjo njësi?(Kërkojmë të na vendoset në dispozicion dokumenti i vendimarrjes për këtë çështje)Nëse jo, cilat janë arsyet e vonesës dhe sfidat e hasura?</p> <p>2.A janë emëruar ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë gjatë periudhës 2020-2021?Nëse po sa ndihmës ligjor janë emëruar? A është mjaftueshëm dhe a ka ndihmuar në përshpejtimin e shqyrtimit të dosjeve gjyqësore?</p>	15.11.2021	<p>1. Njësia e shërbimit ligjor është krijuar me vendimin nr.495, date 21.10.2020, të KLGJ-së “Për krijimin e njësive të shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”.</p> <p>2. Për periudhën 2020-2021 janë emëruar përkohësisht 10 ndihmës ligjorë si më poshtë: Me vendimin nr.553, date 12.11.2020, të KLGJ-së “Për detajimin e pozicioneve aktuale të ndihmësve ligjorë nga gjykata administrative të</p>	E plotë	Nuk ka

		<p>3. A është numri i ndihmësve ligjor në përputhje me parashikimet e Ligjit 98/2016? Nëse numri është i tejkaluar ose në mungesë, cila është arsyeja?</p> <p>4. Sa ka ndikuar në mbarëvajtjen e veprimtarisë së gjykatës situata e krijuar nga pandemia Covid 19, pasi Klgj vendosi në datën 10.03.2020 pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjithë gjykatat e vendit deri në datën 22.04.2020? Keni të dhëna se sa është numëri i çështjeve të mbartura gjatë kësaj periudhe?</p> <p>5. A ka pasur kërkesa dërguar prej jush KLGJ-së në raport me shërbimin civil gjyqësor dhe cilat masa janë marrë konkretisht për gjykatën tuaj? Si kanë ndikuar këto masa në ngarkesën e gjyqtarëve me çështje?</p> <p>6. A ka pasur lëvizje paralele gjatë periudhës 2020-2021? Sa të tilla?</p> <p>7. A ka pasur kërkesa dërguar prej jush KLGJ-së në raport me shërbimin civil gjyqësor dhe cilat masa janë marrë konkretisht për gjykatën tuaj? Si kanë ndikuar këto masa në ngarkesën e gjyqtarëve me çështje?</p>		<p>shkallës së parë pranë gjykatës të apelit”, janë emëruar përkohësisht 5 ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilët kishin ushtruar detyrën pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.</p> <p>Me vendimin nr.614, 616, 611, 615,613, datë 10.12.2020, të KLGJ-së janë emëruar përkohësisht në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, 5 ndihmës ligjor.</p> <p>-Ndihmësi ligjor ka mardhënie të drejtpërdrejt me gjyqtarin për përgatitjen e relacionit në lidhje me çështjen e ngarkuar nga gjyqtari.Pritet një rritje e performancës së tyre.</p> <p>3. Numri i ndihmesave ligjor sipas organikes se Gjykatës së Apelit Tiranë është 15, nga të cilët aktualisht ushtrojnë detyrën si ndihmës pranë Gjykatës 10 ndihmës ligjor. Në mungesë janë 5 ndihmës</p>		
--	--	--	--	--	--	--

	<p>8.A janë kryer trajnime të kancelarit, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjor? A janë kryer trajnime të nëpunësve gjyqësor ? Sa të tilla? Në cilat fusha?</p> <p>9. A janë përfshirë gjyqtarët në trajnime gjatë periudhës 2020-2021? Sa trajnime janë realizuar dhe nga kush janë ndërmarrë këto trajnime (Shkolla e Magjistraturës apo organizata/institucione në kuadër të zbatimit të projekteve)?</p> <p>10. A ka pasur gjykata juaj nevojë për rikonstruktim, apo për ndërhyrje për përmirësim godinë? Nëse po, a keni informuar KLGJ-në, mbi këtë nevojë dhe çfarë masash janë marrë prej saj?</p> <p>11.A është ngritur tek ju sistemi i arkivimit gjyqësor? Si funksionon?</p> <p>12. A përdorin gjyqtarët dhe stafi i gjykatës modele standarte elektronike për draftimin e vendimeve gjyqësore?</p> <p>13.Sa gjyqtarë nuk e kanë kaluar procesin e vetingut, sa të tillë janë në proces dhe sa e kanë kaluar përmes një vendimi përfundimtar? Si ka ndikuar kjo në ngarkesën e çështjeve? Si janë shpërndarë dosjet e secilit gjyqtar tek gjyqtarët e tjerë?</p>		<p>ligjorë, për të cilët pritet emërimi nga KLGJ.</p> <p>4. Gjykata e Apelit Tirane ka funksionuar gjatë gjithë periudhës së pandemisë, me seanca gjyqësore të reduktuara, dhe vetëm për periudhën 10.03.2020-22.04.2020 janë shqyrtuar gjithsej :</p> <p>85- masa sigurimi ;Penale themeli-13 ;Civile themeli 7; kërkesa pezullim – rivendosje 4.</p> <p>5. Nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë, nuk ka patur kërkesa drejtuar KLGJ-së në raport me shërbimin civil gjyqësor.</p> <p>6. Për vitin 2020 ka patur 1 levizje paralele në pozicionin e Kryetares së Degës së Buxhetit, kurse për vitin 2021 ka patur 6 lëvizje paralele në pozicionin sekretar gjyqësor.</p> <p>8.Kancelari ka kryer trajnime të ndryshme dhe konkretisht:</p> <p>-Trajnime nga shkolla e Magjistratures me temë “Leadership i Ekipit</p>		
--	--	--	--	--	--

		<p>14. Mbi c'kritere përcaktohet marrja në shqyrtim e dosjeve? Në bazë të rendit kohor që janë paarqitur apo edhe rëndësisë dhe urgjencës me të cilat lidhen problematikat e dosjeve?</p> <p>15. A përfundohen çështjet gjyqësore sipas afateve të arsyeshme, të parashikuar nga neni 399/2 i K.Pr.Civile?</p> <p>16. Dosjet e cilit vit janë duke u marrë në shqyrtim aktualisht nga gjykata juaj (përfundim bëjnë këtu çështjet e natyrës urgjente)?</p> <p>17. Miratuar me ligjin nr.46/2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 98/2016" Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"-gjkata e shkallës së parë dhe të apelit të gjykojnë më trupa gjykues të përbërë nga një gjyqtar, ose me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. A po zbatohet dhe si ky parashikim i ri procedural? A keni statistika zyrtare rreth ndikimit të këtyre ndryshimeve?</p> <p>18. A mendoni se janë të nevojshëm ndryshime të mëtejshme ligjore me qëllim rritjen e efencës në gjyqësor?</p>		<p>Drejtues", "Mardheniet e Gjykatës me publikun dhe median".</p> <p>-Programin për administrimin e gjykatës , Trajnim i kancelareve ne detyre per periudhen 6 Qershor-26 Korrik 2019 (USAID Shkolla e Magjistratures)</p> <p>-Trajnim të organizuar nga Euralius (konsultimi mbi planin e veprimit dhe indikatorëve te startegjise ndersektorale te drejtesise 2018-2021" "Rritje e efencës ne gjykata", "Administrimi i gjykates dhe statistikat si mjete startegjike per permiresimin e performances", "Marrëdhëniet e gjyqësorit me median", "Drejtësia elektronike" "Sistemi ICMIS", etj</p> <p>-Trajnim i organizura nga Akshi</p> <p>-Trajtime te ndryshme te organizuara nga USAID</p>		
--	--	--	--	--	--	--

		<p>19. Cilat janë çështjet për të cilat i jeni drejtuar më shpesh me kërkesa KLGJ-së? Sa prej tyre janë marrë në konsideratë nga KLGJ?</p> <p>20.A mbahen rregullisht mbledhjet e gjyqtarëve të paktën një herë në muaj?</p>		<p>Ndihmesit ligjor kane kryer trajnimet e meposhtme:</p> <p>-Zbatimi i drejtësisë administrative,risitë proceduriale”,organizuar nga Shkolla e Magjistratures.</p> <p>-“Zhvillime te legjislacionit te prokurimeve publike dhe atij fiskal ne kendeveshtrimin e gjykimeve administrative”organizuar nga Shkolla e Magjistratures</p> <p>-Trajnimi , ‘Institute të së drejtës proceduriale administrative sipas K.Pr.A” organizuar nga Shkolla e Magjistratures</p> <p>-Trajnimi “ Standartet evropiane mbi të drejtën e azilit”organizuar nga Shkolla e Magjistratures</p> <p>-Trajnim pjesmarrje në trajnimin TVSH, tatimi mbi të ardhurat dhe taksimi ndërkombëtar në ndihmë të gjykimeve administrative”, organizuar nga Shkolla e Magjistratures.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>-Trajnimi “ Jurisprudenca e GJEDNJ , lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar. Konventa e OKB dhe legjislacioni shqiptar lidhur me PAK dhe roli i sistemit të drejtësisë”, organizuar nga Shkolla e Magjistratures</p> <p>-Trajnimi “Risite e Kuadrit Ligjor per administraten publike”organizuar nga Shkolla e Magjistratures.</p> <p>-Trajnim “Standartet e GJEDNJ për nenin 6 Konventës” organizuar nga Shkolla e Magjistratures</p> <p>-Trajnim“Risite e Kodit të Proçedurës Administrative”, organizuar nga Shkolla e Magjistratures</p> <p>-Trajnim “Reforma për mbrojtjen e të dhënave personale, procesi i përafrimit dhe jurisprudenca”, organizuar nga Shkolla e Magjistratures</p> <p>-Trajnim “Natyra e mjeteve ligjore administrative,</p>	
--	--	--	--	--	--

				<p>organizuar nga Shkolla e Magjistratures</p> <p>-Trajnimi “Regjimi pasuror martesor i bashkësise ligjore”, organizuar nga Shkolla e Magjistratures</p> <p>-Trajnimi “ Dilema në përcaktimin e kompetencës lëndore për GJAD apo Gjykatën Kushtetuese, organizuar nga Shkolla e Magjistratures</p> <p>Nga Klj në bashkëpunimin me Euralius dhe Projektin Justice for All është kryer trajnimi pilot i nëpunësit civil gjyqësor në modulet:</p> <p>-Moduli Hyrje ne Administraten Gjyqesore</p> <p>-Moduli per Etiken</p> <p>-Moduli Burimet Njerezore</p> <p>-Moduli per menaxhimin e Levizjes se Ceshtjeve</p> <p>-Moduli per Buxhetin dhe Finances</p> <p>-Moduli per Marrëdhëniet me publikun</p> <p>-Moduli per Shkrim dhe arsyetim ligjor</p>	
--	--	--	--	--	--

			<p>Në lidhje me nëpunësit civil gjyqësor kemi shprehur me kërkesë nevojat për trajnim drejtuar Shkollës së Magjistraturës dhe KLGj-se, të cilat janë marrë në konsideratë.</p> <p>9. Të dhënat e mësipërme disponohen nga Shkolla e Magjistraturës që realizon trajnimin vazhdues. I jemi drejtuar Shkolles se Magjistraturës për listën e trajnime, të cilën do tju vendosim në dispozicion sapo të na e dërgojnë.</p> <p>10.Gjykata e Apelit Tiranë, nuk ka patur nevojë për rikonstruktim deri më sot.</p> <p>11.Prane Gjykatës së Apelit Tiranë është ngritur Komisioni i Ekspertizes për arkivën gjyqësore me Vendimin e Këshillit të Gjykatës të datës 15.10.2021.</p> <p>12. Jo, gjyqtarët dhe stafi nuk përdorin modele standarte per draftimin e vendimeve, por gjyqtarët janë të mendimit që nëse do i përdornin këto modele standarte do të kishte</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>evadim më të lartë të numrit të çështjeve gjyqësore të gjykuara.</p> <p>13.Nuk kanë kaluar procesin e vetingut 13 gjyqtar, nga te cilet 3 gjyqtarë janë te shkarkuar me vendim te formes se prere.</p> <p>Kanë kaluar procesin e vetingut 9 gjyqtarë, nga të cilët 2 gjyqëtarë janë emëruar në Gjykatë të Lartë, ndërsa 4 gjyqtarë ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (duke përfshirë gjyqtar Ilir Toska, i cili është anëtar i KLGj). Të ankimuar në KPA janë 3 gjyqtarë (të konfirmuar në KPK dhe të ankimuar).</p> <p>Me dorëheqje janë larguar nga detyra 6 gjyqtarë.</p> <p>Shkarkimi/pezullimi/doreheqjet e gjyqtarëve ka ndikuar shumë në ngarkesën e gjyqtarëve që ushtrojnë aktualisht detyrën pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Pas cdo largimi nga detyra, ngarkesa e gjyqtarëve (çështjet</p>	
--	--	--	---	--

			<p>gjqësore) është rishortuar në mënyrë të barabartë midis gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë. Bashkëlidhur statistika zyrtare deri në datën 30.09.2021.</p> <p>14. Si rregull, dosjet planifikohen për gjykim nga gjyqtari relator sipas datës së regjistrimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, përvec çështjeve penale emergjente, masave të sigurimit penale, apo çështjeve me afat. Me kërkesë të palëve ndërgjyqëse gjyqtari relator mund të përshpejtojë datën e gjykimit në bazë të vendimit nr. 78 datë 30.05.2019 të KLGJ-së “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit Tiranë”.</p> <p>15. Për shkak të numrit të ulët të gjyqtarëve, dhe ngarkesës së lartë të çështjeve në shqyrtim, është e pamundur që të gjykohen të gjitha çështjet gjyqësore në afate të arsyeshme, sipas nenit 399/2 të K.Pr.Civile.</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>16. Aktualisht sipas radhës së regjistrimit, janë në shqyrtim dosjet e vitit 2017, duke përjashtuar çështet gjyqësore të natyrës urgjente.</p> <p>17. Parashikimi i ri ligjor, për gjykimin e çështjeve të caktuara me 1 gjyqtar zbatohet dhe ky parashikim i ka dhënë ndihmë evadimit të çështjeve gjyqësore dhe anëtarët e trupit gjykues mund të merren me studim/ arsyetim/gjykim të çështjeve të tyre.</p> <p>18. Kjo është një pyetje të cilës nuk mund ti përgjigjem unë si Kancelar.</p> <p>19. Çështjet për të cilat i jemi drejtuar më shpesh KLGJ-së, janë:</p> <ul style="list-style-type: none">-Kërkesa për delegim gjyqëtarësh, të cilat janë marrë në konsideratë brënda afatit të kërkuar- Kërkesë për delegim gjyqtarësh për një periudhë 6-mujore/ për një periudhë një vjecare, dy trupa gjyqësor, për nevoja gjykimi (Shkresa nr.860 prot, datë 17.02.2021 e	
--	--	--	---	--

				Gjykatës së Apelit Tiranë”.Por për këtë shkresë nuk kemi ende një përgjigje zyrtare. 20. Për shkak të numrit të ulët të gjyqtarëve, mbledhje zhvillohen shpesh, për problematika të ndryshme të hasura gjatë kryerjes së detyrës, por jo të formalizuara.		
6	09.11.2021	Vënien në dispozicion të transkriptimit ose rregjistrimi audio i seancës përfundimtare e mbajtur në Maj 2020, ku është marrë vendimi përfundimtar lidhur me çështjen ku i pandehur ka qënë kreu i P.D,L.B dhe dy ish-zyrtarët e kësaj partie, A.R dhe I.D, lidhur me kontratat e lobimit në SHBA.	15.11.2021	Në përgjigje të kërkesës tuaj, datë 09.11.2021 bashkëlidhur ju dërgojm rregjistrimin audio të seancës gjyqësore të dates 14.05.2020.	E plote	Nuk ka
7	09.11.2021	Vënien në dispozicion të vendimit të plotë gjyqësor (vendimi përfundimtar i arsyetuar) i marrë në Maj 2020, ku i pandehur ka qënë kreu i P.D, L.B dhe dy	15.11.2021	Në përgjigje të kërkesës tuaj, datë 09.11.2021 bashkëlidhur ju dërgojmë vendimin nr. 194 datë 14.05.2021 të Gjykatës	E plote	Nuk ka

		ish-zyrtarët e kësaj partie, A.R dhe I.D, lidhur me kontratat e lobimit në SHBA		së Apelit Tiranë, të anonimizuar.		
8	24.11.2021	Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për të pandehurin shtetasin N.H	01.12.2021	Në përgjigje të kërimit tuaj, bashkëlidhur do të mund të gjeni vendimin penal në formë të anonimizuar për pandehurin shtetasin N.H	E plote	Nuk ka

¹Numri i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

¹Data e regjistrimit të kërkesës

¹Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

¹Data e kthimit të përgjigjes

¹Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

¹Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/ E deleguar

¹Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.